



Republika e Kosovës



Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)—  
01.Nr. zyrtar/ 2025

### Procesverbal

**Takimi i I-rë i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025**

**Më 04.03.2025**

Në takim prezantuan:

**Besim Ilazi**, Kryetar i Komunës

**Zahir Doda**, DKA

**Halim Shehu**, Stacioni i Policisë-Kaçanik

**Fidaim Fazliu**-KBI

**Fatmir Qaka**, EVSB

**Bujar Bajra**-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

**Elmihane Malsiu**-HANDIKOS

**Naim Hysa**-Kryqi i Kuq Komunal

**Jashar Selimi**-Këshilli i Prindërve

**Ylber Tusha**-Përfajqsues i bizneseve

**Shemsedin Abazi**-KLSP

**Agon Berisha**-FSK

**Fadil Guri-Zyra** për Komunitete dhe Kthim

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës .

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar .
- 2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut në periudhën mes dy takimeve .
- 3.Analiza e rekomandimeve të vitit 2024 – identifikimi i prioriteteve për vitin 2025.
- 4.Të ndryshme .

#### **1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar .**

-Pika e parë e rendit të ditës miratohet nga të pranishmit .

#### **2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut në periudhën mes dy takimeve .**

-Për gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë z.Halim Shehu .

**Halim Shehu** – Gjatë kësaj periudhe kohore në mes dy takimeve kanë ndodhur gjithsejtë 63 raste kriminale që nuk don të thot se kanë qenë raste të rënda kriminale .

Nga këto raste mundë, të i veçojmë 17 vjedhje , vjedhje të rënda janë 8 raste , kanosje 6 raste që janë shqetësuese ,3 raste dhunë në familje , ndërhyrje në sistemin kompjuterik kemi 1 rast, 1 rast sulm , shantazh 1 rast ,dëmtim prone 6 raste , 13 raste të dëmtimit të lehtë trupor , rrezikim në vendë të punës 2 raste ,dëmtim i instalimeve publike 1 rast ,posedim të lëndëve narkotike 1 rast , posedim i armëve pa leje 2 raste .

Pasi që kemi hyrë në muajin e Ramazanit frekuentimi i njerëzve është më i madh dhe kemi një plan operativ për të menagjuar situatën .

Shqetësuese është dëmtimi i pyjeve , situata e sigurisë është e qetë nëpër shkolla .

Mungesa e kamerave të sigurisë në Komunën tonë po na e vështirson edhe punën tonë në identifikimin e rasteve dhe uroj që kjo qështje të zgjidhet sa më shpejtë.

Zgjatja e punimeve në magjistrale e ka vështirësuar komunikacionin në qytet dhe për kët ka ankesa të vozitësve të kamionve të cilët e kanë të ndaluar të qarkullojn në rrugën alternative në qytet ku në shum raste ata edhe gjobiten per shkakë të mosrespektimit të shenjave të komunikacionit të cilat janë vendosë nga institucionet përkatëse .

Në përgjithësi mundë të them se gjendja e sigurisë në peridhën në mes dy takimeve ka qenë e qetë .

**Ramadush Osmani** – Shenjet e komunikacionit për ndalim qarkullimi për automjetet me peshë të rëndë i kemi vendosur ne si Komunë me qëllim që të mos dëmtohet rruga dhe ju si Polici duhet ta zbatoni ligjin mbi komunikacionin .

**Kryetari** – Ka pasë ankesa të shumta nga vozitësit e peshave të rënda por që këto ankesa janë të pabaza ngase zgjidhje ka por që duhet të bëjnë një rrugë më të gjatë duke e përdorur autostradën.

**Halim Shehu** – Zyrtarët policorë gjatë punës në teren në disa fshatra të boshatisura kanë vërejtur disa shtëpi të vjetra që janë rrezik potencial për shembje e që mundë të paraqesin ndonjë rrezik dhe mendoj se është mirë të dilet në teren dhe të identifikohet çdo gjë që mundë të paraqes rrezik potencial .

**Bujar Bajra** – Sektori i emergjencave ka dalë në teren dhe ka bërë identifikimin e objekteve që mundë të paraqesin rrezik potencial dhe tash jemi në fazën e lajmërimit të pronarëve të këtyre objekteve .

### **3.Analiza e rekomandimeve të vitit 2024 – identifikimi i prioriteteve për vitin 2025.**

-Në pikën e tretë të rendit të ditës u diskutua rreth rekomandimeve që i kemi dhënë gjatë takimeve që janë mbajtur në vitin 2024 ku sipas Kryetarit jemi munduar që të i zbatojmë, disa janë në zbatim e sipër e disa prej tyre nuk janë në kompetenca të Komunës .

**Ramadush Osmani** – Drejtoria e Shërbimeve Publike sado që ka marrë masa për qentë endacak mund të them se nuk ka pas ndonjë efekt ngase numri i qenëve endacak nuk është zgjeluar.

Ne si Komunë pa ndonjë kordinim me nivelin regional nuk mundë të bëjmë ndonjë zgjidhje sa i përket kësaj qështje .

Jemi në pritje të implementimit të strategjisë nationale ku mendohet të bëhet një vend grumbullim i qenëve endacak dhe trajtimi i tyre të bëhet në bazë të strategjisë .

**Kryetari** – Ndër ankesat dhe kërkeshat më të mëdha të qytetarëve vitin e kaluar ka qenë mungesa e ujit të pjes që ka qenë një sfidë e madhe edhe për ne si Komunë .

Investimet në infrastrukturë sa i përket ujit të pijshëm në Komunën tonë janë bërë me atë kapacitet bugjetor që e kemi pasur por që pjesa menagjeriale e kompanis ka ngecur .

Kompania e ujit siq edhe jeni të informuar ka kaluar nga kompetenca e nivelit regional në atë qendëror dhe me keqardhje po e them se me gjithë tentimet tona për takime e bashkëpunime ata nuk u janë përgjigjur thirrjeve tona .

Unë si Kryetarë Komune e kam ngritur kët qështje edhe në mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe i kemi ftuar edhe ata që të na informojnë për kët qështje por që nuk e kanë parë të arsyeshme të takohen .

I njoftojë qytetarët që adresa e ankesave , protestave dhe veprimeve tjera për të shfaqur pakënaqësi me problemen e ujit është niveli qendëror i cili nuk tregon forma të bashkëpunimit me nivelin lokal për zgjidhjen e këtij problemi por edhe problematikave tjera që hasen nëpër Komuna e posaqërisht në komunën tonë .

**Fidaim Fazliu** – Kemi hyrë në muajin e shejtë të Ramazanit dhe kisha kërkku një mobilizim dhe një angazhim më të theksuar të Policisë sidomos për rreth Xhamive .

Deshta me u ndërlidhë me krijimin e kompanive publike në qytet ku si kërkeshë e imja e kahmotshme ka qenë për një trotuar para hymjes në Xhaminë e qytetit .

**Inspektorët** të dalin në teren dhe të i kontrollojnë marketet ngase po e shfrytëzojnë muajin e Ramazanit dhe po shpërndajnë ndihma me afat të skaduar të ushqimit .

**Kryetari** – Do e shohim mundësin për një trotuar para Xhamisë nëse ka hapësirë e sa i përket inspektiveve në markete edhe pse inspektorin sanitari nuk e kemi , do të gjejmë mekanizma tjerë që do e zgjidhin kët qështje .

**Fadil Guri** – Deshta me ngritë një shqetësim të komunitetit të fshatit Nikaj lidhur me një dëmtim të pronës afér varrezave të qytetit afér fshatit Stagovë .

Prona e banorëve të fshatit Nikaj në kët pjesë është 44 hektar zabel dhe nga ajo që kemi vrejtur është se një pjesë e madhe është shkatërruar nga dora e njeriut .

Propozoj që Kuvendi Komunal të formoj një komision nga të gjitha partitë politike të dalin në kët teren , të bisedojnë me banorët e fshatit Nikaj dhe të fshatit Stagovë dhe të i shtrojnë problemet që kanë se përndryshe mundë të ketë ndonjë ekces .

**Kryetari** – Për pronat Komunale Kuvendi Komunal mundë të veproj nëse është interes i komunitetit ndërsa për rastin që ju po e potenconi Komuna nuk ka kurrfar interesit ngase është pronë private .

Për kët ju duhet të drejtoheni tek inspektorati i pylltarisë dhe tek Policia .

Për pronat private nëse është zonë interesit janë disa procedura që Kuvendi Komunal vendosë për shpronsim ndërsa në rastin e juaj ne si institucion nuk kemi drejtë që të ndërhyjm pos në ndërmjetësim në pajtim të palëve.

**Dardan Duraku** – Jam nga Ministria e Punëve të Mbrendshme, Departamenti për Siguri Publike dhe për fillim desha të përshëndes Kryetarin dhe gjithë juve duke ju përgzuar për punën që po e bëni .

Gjatë vlerësimeve që kemi bërë nëpër Komuna, Komuna e Kaçanikut është Komunë me performancë më të mirë në gjithë Kosovën sa i përket KKSB-ve .

Shqetësim nacional janë dukurit negative nëpër Shkolla , qentë endacak dhe dhuna në familje .

Po shpresojmë që me zgjedhjen e Qeverisë së re, me raportet që kemi përgatitur do të punohet më konkretisht në parandalimin e këtyre dukurive .

**Kryetari** – Një shqetësim që është ngritë kohëve të fundit tek qytetarët është ngritja e qmimit të antarsisë për Bashkësin Islam me arsyetim se janë blerë makineri për shërbime të Vorrimit .

Ne si Komunë nga janari i këtij viti kemi marrë një vendim që shumën prej 175 eurove që janë mbulu nga Komuna për shërbime të vorrimit ta rrisim në 300 euro që këtu hynë edhe hapja e varrit dhe ju duhet ta arsyetoni tek qytetarët arsyen e ngritjes së qmimit të antarsisë.

**Fidaim Fazliu** – Uroj që edhe ne si Baskësi Islamë të hyjmë nën ombrellën e shtetit dhe punët të shkojnë mbarë .

Shfrytëzoj rastin të ju falenderoj për një vendim që keni marrë për rritjen e bugjetit për shërbime të varrimit të cilin falenderim e kemi shpërndarë në të gjitha Xhamitë e Komunës tonë .

Vendimin për ngritjen e qmimit të antarsisë e kemi marrë më herët por që ka hy në fuqi në fillim të këtij viti me arsyetim të mbulimit të disa shërbimeve tjera në Bashkësin Islame duke e përfshirë edhe pagat e stafit që janë gjithsej 36 .

Informacionet që janë blerë makineri për shërbime të varrimit nuk janë të vërteta dhe ky informacion ju garantoj se nuk ka dalë nga stafi Bashkësis Islame .

Ngritjen e qmimit të antarsisë e kemi bërë në koordinim edhe me Komunat tjera ngase nevojat janë shtuar .

**Fatmir Qaka** – Ka pasur vërejtje nga anëtarët e Kuvendit Komunal lidhur me raportet e KKSBS-së duke aluduar që janë shumë të shkurta dhe mendoj se duhet të ju sqarohet atyre se rapporti 6 mujor dhe një vjeqar është një raport që tregon aktivitetet e KKSBS-së ku kryesisht janë takimet , diskutimet që bëhen në kët këshill e poashtu janë edhe rekomandimet që nxirren në këto takime .

Gjithashtu desha me adresu një shqetësim të një grupei qytetarë lidhur me zërin e ngritur gjatë faljes së vaktit të namazeve nëpër Xhami .

Ai grup thotë se me fillimin e muajit të Ramazanit është ngritë akustika .

**Dardan Duraku** – Sa i përket raportimit unë mundë të them se rapporti vlerësohet në cilësi e jo në vëllim , kështu që unë veq mundem me ju përgëzu me punën që po e bëni .

**Fidaim Fazliu** – Duhet të respektohet ligji që përcakton tonalitetin e zërit dhe mundë të ju them se ne nuk kemi ndryshu asgjë në këtë muaj sa i përket kësaj qështje .

**Kryetari** – Nëse Asambleistët e Kuvendit Komunal dojnë një raport më të detajuar atëher ata mundë të njoftohen në procesverbalet të cilat i publikojmë në webfaqen e Komunës ndërsa sa i përket zhurmës akustike ne nuk kemi kompetenca të mirremi me kët punë ngase janë kompanitë e licencuara të cilët mirren me kët qështje .

**Naim Hysa** – Shqetësim i komunitetit të fshatit Stagovë është bllokimi i rrugës së varrezave të qytetit e që lidhë edhe fshatin Stagovë sidomos në rastet e ceremonive mortore .

**Halim Shehu** – Një problematikë e pazgjedhur në qytet është mosfunkcionimi i kamerave të sigurisë , problematikë që duhet të veprohet në zgjidhjen e kësaj qështje .

**Kryetari** – Bllokimi i rrugës që të shpie në drejtim të varrezave të qytetit është si pasojë e mos vedijsimit të vozitësve të cilët edhe pse ka mjaftueshëm hapësirë për parking ata bëjn pengimin e komunikacionit në kët rrugë .

Qështja e kamerave të sigurisë është një shqetësim por që nuk është neglizhencë e Komunës .

Problemi qëndron tek mirëmbajtja e që neve si institucion ligji nuk na e lejon .

Do e shohim si mundësi që përmes një projekti për instalim të kamerave të sigurisë nëpër shkolla të bëjm një zgjidhje .

## **Rekomandimet**

- 1.Të respektohet ligji për komunikacion pavarsisht të ankesave që ju drejtohen Institucioneve .
- 2.Të identifikohen objektet e vjetra që mundë të paraqesin rrezik potencial dhe të mirren masa paraprake .
- 3.Një koordinim i veprimeve të institucioneve të nivelit qendrorë dhe lokal në trajtimin e qenëve endacak.
- 4..Të mirren masa paraprake për sigurimin e ujit të pijshëm sidomos gjat sezonit të verës .
- 5.Inspektorët Komunal të janë më aktiv sidomos gjatë inspektimeve të marketeve të cilët kanë produkte me afat të skaduar .
- 6.Të ndjeken rrugët ligjore në mbrojtjen e pronës private .
- 7.Të respektohet ligji që ndalon ndotjen akustike .
- 8.Veprime konkrete në parandalimin e dukurive negative e sidomos nëpër shkolla .
- 9.Të punohet më shumë në zgjidhjen e qështjes së kamerave të sigurisë .

Kryesoi – Kryetari

z.Besim Ilazi



Procesmbajtës

Fatmir Qaka